VENDIM
Nr. 172, datë 31.7.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 12 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2122/1 prot., datë 21.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Global Technical Mechanics' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

Konstatoi se:

- Shoqëria "Global Technical Mechanics" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2122 prot., datë 18.7.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 12 MW, me vendndodhje në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të *"Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"*, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave ("a", "b" dhe "c"), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaron se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave ("a" dhe "b").

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 175, datë 20.3.2025 *"Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike për vetprodhim dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës, nga shoqëria 'Global Technical Mechanics' sh.p.k."*.

- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 2718 rep., nr. 1082 kol., datë 23.5.2025 "*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike për vetëprodhim, me kapacitet prodhues 12 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën e aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës, nga shoqëria 'Global Technical Mechanics' sh.p.k."*.

- Shoqëria ka marrë miratimin e pikës së lidhjes nëpërmjet shkresës së "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" (OSSH) sh.a. me nr. 10278/3 prot., datë 3.10.2024.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1: Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- Shoqëria duhet të informojë në rast se struktura organizative e depozituar është aktualisht funksionale apo do të jetë në të ardhmen. **(germa "c")**

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

Shoqëria duhet të depozitojë:

- Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. **(germa "a")**
- Dokumentacion vërtetues për mbështetjen financiare për realizimin e projektit. **(germa "b")**
- Planin e biznesit. **(germa "c")**

Pika 2: Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- Të dhënat për sa i përket datës së fillimit të operimit. **(germa "a")**
- Kontratën me MIE-n në formatin origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin. **(germa "b")**
- Miratimin e pikës së lidhjes nga OSSH sh.a. në formatin origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin. **(germa "c")**
- VNM-në paraprake, si dhe të bëjë me dije në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit. **(germa "e")**

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Global Technical Mechanics" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 12 MW, me vendndodhje në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Global Technical Mechanics" sh.p.k., dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti